



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1595 prot.

Fushë-Arrëz, më 11.06.2025

VENDIM

Nr. 19, datë 09.06.2025

PËR

**PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR TË EMERGJENCAVE CIVILE ME OBJEKT
“NDËRTIM MURI MBAJTËS RRUGA AUTO, LAGJIA SHPOZ, DEGËZIMI DJATHTAS
(NDËRHYRJE EMERGJENTE)”**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; neni 29 i Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”; Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; neni 30, shkronja “gj”, VKM nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; kërkesën me Nr. 03 prot. datë 02.06.2025 të Kryetarit të Fshatit Fushë-Arrëz, lagjia Fushagji, Bashkia Fushë-Arrëz; në bazë të dokumentave të sjella me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, **Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz në mbledhjen jashtë radhe të datës 09.06.2025**, pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura,

VENDOSI

1. Përdorimin e shumës prej, **1 087 214** (një milion e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e katërmëdhjetë) lekë nga fondi i Emergjencave Civile, me objekt “Ndërtim muri mbajtës rruga auto, lagjia Shpoz, degëzimi djathtas (Ndërhyrje emergjente)”, e cila përdoret në grup, titull, kapitull dhe artikull si më poshtë:

17-10910-01, 604 shuma prej **498 509** mijë lekë do të merret nga fondi i kushtëzuar i Emergjencave Civile të dërguar për Bashkinë Fushë Arrëz nga Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe 00.03280-01, 609 shuma prej **588 705** lekë do të merret nga fondi i Emergjencave Civile të Bashkisë, ku vlera totale e investimit është **1 087 214 lekë**.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori Emergjencave Civile dhe i Financës, Njësia e Prokurimeve Publike.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Zbardhur, më 11.06.2025

Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike sipas pikës 6, Neni 55 i Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

